



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **21.02.2022** me fillim në ora **15.30**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB tani më me përbërje të re, të cilët kanë marrë miratimin edhe nga kuvendi i komunës, i dëshiroj shëndet dhe punë të mbarë, poashtu përshëndes nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu nëntogerin Gëzim Morina dhe rreshterin Amrush Morina, një përshëndetje të veçantë për prezencën e tyre në këtë mbledhje ekipin amerikan. Përshëndes poashtu edhe përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e parë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2022 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;**
3. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
 - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak,
 - Siguria në Trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
4. **Të ndryshme.**

Kryetari - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Procesverbali është nga viti i kaluar, poashtu edhe nga përbërja tjetër, por ne duhet që ta aprovojmë sepse duhet të futet në veb faqe të komunës. A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Kryetari – Do i jap disa informata sa i përket situatës me Covid – 19 në komunën e Rahovecit. Këtu është prezent edhe drejtoresha e shëndetësisë z. Saranda Sallteku, unë do i them disa fjalë sa i përket situatës me Covid – 19, nëse ka diçka më shumë mundet të më plotësoj edhe drejtoresha. Gjendja me pandeminë Covid – 19 është më stabile në komunën tonë, pra efekti i virusit nuk është më ai i cili ka qenë, kemi raste në

komunën tonë, por shumë më pak, poashtu vazhdon procesi i vaksinimit edhe me dozën e tretë, vaksinat tani janë nga Faizer, ne i kemi statistikën se sa janë të vaksinuar me dozën e parë, të dytë dhe të tretë. Vazhdon testimi me testet rapide, kemi edhe ekipin mobil për vaksinimin e atyre rasteve që janë të shtyrë në moshë ose që janë të palëvizshëm. Komuna e ka aktivizuar edhe numrin emergjent, është numër që bëhen thirrje falës nga qytetarët që kanë nevojë për ofrimin e ndihmës dhe është aktiv 24 orë. Tani disa nga masat janë hequr, pra kemi zbutje të masave, por ende disa nga masat janë në fuqi si ora policore, si qytetar i komunës dhe si kryetar i kësaj komune dëshiroj që nga kjo mbledhje e KKS-së të bëjë apel Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shkohet edhe më tutje me zbutjen e masave sepse efekti i virusit ka filluar që të zbehet dhe sipas mendimit time ne jemi duke shkuar nga përmbyllja e kësaj situatë e cila ka lënë shumë pasoja si në humbje të njerëzve dhe në gjendjen socio ekonomike. Komuna vazhdon ta ketë një shtab emergjent komunal, por kryesisht detyrat e këtij shtabi janë përqendruar kryesisht tek funksionet që i ushtrojnë DSHPS-ja, udhëheqja e QKMF-së, policia e Kosovës dhe inspektorati, mundet të ketë edhe gjopa si pasojë e shkeljes së masave dhe rregullave anti - covid. Për më shumë fjalën ja japë drejtoreshës së DSHPS-së.

Saranda Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, numri i rasteve sa i përket virusit Covid – 19 ka rënë dukshëm, për momentin në komunën e Rahovecit kemi 93 raste aktive, të shëruar kemi rreth 200 persona, fjala është për vitin 2021, kurse të vaksinuar në Komunën e Rahovecit janë rreth 84% e popullsisë.

Kryetari – Fjala është e juaja, nëse ka dikush të shtoj diçka sa i përket Covid – 19. Nëse nuk ka askush të shtoj diçka atëherë unë në emër të këtij këshilli do të dalim me një konkluzë për këtë pikë të rendit të ditës:

Konkluzë: I bëjë thirrje qytetarëve të pa vaksinuar që të vaksinohen, sepse ne si komunë i kemi të gjitha kushtet e përshtatshme që vaksinimi të vazhdojë. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit. Ndërmjet dy takimeve të KKS-së, takimit me përbërjen e kaluar dhe të këtij takimi me përbërje të re, në bazë të informatave që ne i disponojmë nuk kemi pasur ndonjë situatë që kishte me qenë faktor që ndikon në prishjen e klimës së përgjithshme të sigurisë në Komunën e Rahovecit. Nuk do të thotë që nuk ka pasur kundërvajtje dhe nuk ka pasur në komunën tonë qytetar të cilët e kanë shkelur ligjin, por mundem të ju them që instalimi i kamareve të sigurisë në pikat kryesore të qytetit dhe në disa fshatra më të mëdhenj, janë argumenti i mjaftueshëm që ti themi qytetarëve tanë që sot shumëçka është më e lehtë që të mbahet stabiliteti dhe siguria sepse ata zbulohen më shpejt nga kamerat. Ne do të vazhdojmë me projektin e kamareve dhe ne i dërgojmë një mesazh keqbërësve që nuk do të kenë lehtë tani e tutje. Kemi filluar që ti lirojmë hapësirat publike, kemi filluar që ti mbrojmë trotualet nga uzurpimet e autonjeteve dhe nga mallrat ushqimore, ky projekt po vazhdon që të sigurohet që trotuari u takon këmbësorëve e jo ekspozimit të mallrave. Ne jemi zotuar që do të shqiptojmë gjopa mandatorë si dhe masa më të rrepta gjithmonë ato që lejohen sipas ligjit për të gjithë ata që tentojnë të shkelin ligjin dhe rrezikojnë interesin publik. Inspektorati ka filluar që ti inspektoj furrat e bukës, pastaj duhet të vizitohen stallat, qumështorët, mishorët, qendrat tregtare dhe dyqanet ushqimore sa i përket mallrave të skaduar. Kujdestaria e barnatoreve në qytet është domosdoshmëri e kohës dhe diçka shumë jetike që të sigurohet qytetari ynë që mos të shkojë as në Malishevë as në Gjakovë sepse në rregulloren e viti 2013 ne e kemi precizuar që kujdestaria e barnatoreve është obliguar, ne tani e tutje nuk do të tolerojmë që mos të respektohet orari i kujdestarisë. Sa i përket uzurpimit të pronave publike ne e kemi një aksion tjetër që jemi duke u përgatitur me e ndërmarrë e sidomos asaj prone e cila mundet të cenojë sigurinë publike, ne jemi në përgatitje të informacione se cilat janë ato uzurpues që e kanë uzurpuar pronat publike. Gjopat mandatorë janë dhe do të jenë më evidente se sa në të kaluarën, janë vendosur disa shenja informuese sa i përket parkingjeve, do të vazhdojë procesi i legalizimit të tyre, ne tani sipas rregullores kemi të drejtë parkingjet publike tu i japim në shfrytëzim për një vit pa kaluar në kuvend, pra dëshiroj që të vendosi një rregull edhe tek parkingjet publike. Poashtu ne jemi duke përgatitur planin e ndryshimit të regjimit të qarkullimit të automjeteve në trafik, pra mundet të lindë nevojë që ndonjë rrugë të bëhet një kahës dhe në kuadër të kësaj të nxirret shtigjet për biçikletë dhe trotualet, këto vendime ne synojmë që të dalin nga kuvendi komunal. Poashtu jemi duke punuar në planin e ri të mobilitetit sepse ka skaduar vitin e kaluar, ky plan i parasheh të gjitha këto veprime ose masa që munden të ndërmerren dhe të rritet standardi si në qarkullim ashtu edhe në komunikim dhe e gjitha kjo shkon në favore të rritjes së sigurisë publike. Sa i përket detajeve dhe statistikave rreth kësaj pike fjalën ja japë komandantit të policisë.

Fazli Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shfrytëzoj rastin që të ju uroj shëndet punë të mbarë pasi jemi edhe në mbledhjen e parë dhe jam duke parë fytyra të reja në këtë mandat. Para jush do të shpalos disa nga aktivitetet kryesore të policisë së Kosovës për periudhën raportuese nga 05.11.2021 – 20.02.2022, gjatë kësaj periudhe raportuese situata e sigurisë në Komunën e Rahovecit ka qenë e qetë dhe stabile, nuk ka pasur indikacione për prishje të rendit dhe qetësisë publike në përmasa të mëdha. Së pari do ja filloj me gjendjen e pandemisë edhe pse numri është në rrënje, mirëpo sidoqoftë akoma nuk ka përfunduar. Ndërsa, sa i përket menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-1 Policia e Kosovës është angazhuar duke punuar me orar rregullt dhe sipas nevojës, ku janë përfshirë të gjitha njësitet e S.P. Rahovec, kohë pas kohe të asistuar edhe nga njësite të specializuara DRP-se Gjakove si: NJRSH-se, NJSO-se dhe NJRKRR-se të cilët janë angazhuara në implementimin e Planit Operativ të DRP-se Gjakove „Për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus COVID-19”, duke vepruar në përputhje me vendimet e Qeverisë dhe zhvillimeve tjera aktuale, për menaxhimin e situatës së pandemisë, në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Po ashtu patrullat tona kanë asistuar dhe vazhdojnë të asistojnë Inspektoret Sanitar, AVUK dhe atyre komunal duke bashkëvepruar sipas kërkesave dhe nevojave në teren, për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19.

Në kuadër të këtij plani, gjatë periudhës raportuese, S.P. Rahovec gjatë aktivitetëve policore janë shqiptuar gjatë si në vijim: **811** gjopa bazuar në Ligjin NR 07/L-006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, prej tyre, **689** gjopa për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, **85** gjopa për mos respektim të orarit të lëvizjes dhe **4** gjopa për organizime-ahengje të ndaluara, **24** gjopa për mos mbajtje të distancës, në kemi pasur tolerancë sepse ky numër kishte me qenë shumë fish më lartë.

Veprat penale të Iniciuara gjatë kësaj periudhe janë: Gjatë kësaj periudhe, në S.P. Rahovec janë regjistruar gjithsej: 150 Raste, prej tyre 144 vepra penale dhe 6 incidente të ndryshme. Nga këto raste mund të veçojmë disa vepra më të rënda: Vjedhje, 16 raste, vjedhje të rënda, 32 raste, dhunë në familje, 21 raste, armë mbajtje pa leje, 05 raste. Për fate të mirë gjatë kësaj periudhe janë zbuluar 22 vepra penale të vjedhjeve të rënda, janë arrestuar 8 persona të dyshuar, 6 prej tyre të mitur. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale në Gjakove, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.

Siguria në komunikacionin rrugor: Siguria në komunikacionin rrugor është për keqardhje, qysh javën e kaluar kemi pasur dy raste me fatalitet dhe këto raste kanë qenë në zonën e përgjegjësisë të zonës së Rahovecit, ku faktori kryesor besoj se është faktori njeri, pastaj duke i paraprirë edhe mirëmbajtja e rrugëve, shenjëzimi i rrugëve magjistrale nuk është bërë që 7 vite si ato vertikale ashtu edhe horizontale. Policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme për ngritjen e sigurisë në komunikacion, për të mundësuar dhe përmirësuar lëvizjen e lirë dhe të sigurtë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor. Nga S.P. Rahovec vazhdon të implementohet P.O “Siguria në trafikun rrugor”, ku në kuadër të këtij plani gjatë periudhës raportuese nga patrullat policore të S.P. Rahovec, janë shënuar: Gjopa në Trafik **2542**

Prishja e rendit dhe qetësisë publike 7 kundërvajtje. Totali i gjobave së bashku me ato për Covid – 19 është: **3360** gjopa. Me 24.01.2022 është përpiluar dhe aktivizuar P.O “Lirimi i hapësirave publike nga Automjetet të paregjistruar, të dëmtuara dhe parkingje ilegale” nga SP-Rahovec, me kërkesë të kryetarit të komunës, dhe në kuadër të këtij plani janë realizuar aktivitetet si në vijim: 8 automjete në gjendje jo të rregullt janë larguar nga hapësirat pas vërejtjeve të dhëna nga Policia e Kosovës, 2 automjete janë konfiskuar nga S.P. Rahovec, 215 Gjopa për parkingje të pa lejuara në trotuar. Janë larguar materiale ndërtimore dhe gjësende të ndryshme të cilat kanë qenë pengese në hapësirat publike.

Siguria Në shkollë: Policia e Kosovës në vazhdimësi është e përkushtuar lidhur me sigurinë e nxënësve, kuadrit arsimor dhe objekteve shkollore, ku gjatë periudhës raportuese, janë bërë vizitat në shkollë dhe kontaktet me kuadrin arsimor, njëkohësisht edhe pika të kontrollit afër shkollave të zonës tone të përgjegjësisë. Po ashtu gjatë këtij muaji, në kuadër të planit vjetor për prezantime në shkollë, hartuar nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim- DPP-Prishtinë dhe sipas agjendës së planifikimit mujor të S.P. Rahovec për ligjëratat në shkollë për muajin Shkurt 2022, janë mbajtur disa aktivitete preventive të prezantuara me anë të ligjëratave për nxënësit e klasave prej VI-IX, me temat „Pasojat e përdorimit të narkotikëve” dhe “Ruajtja e Ambientit dhe trashëgimisë kulturore”, ku deri me sot janë përfshirë 9 shkollë fillore të komunës sonë. Këto aktivitete do të zhvillohen në vazhdimësi, për çdo muaj me prezantimin e

temave të ndryshme sipas planit vjetor. Sa i përket rasteve në shkolla, gjate përdhesh raportuese, në shkollat e zonës tone të përgjegjësisë, janë raportuar: 1 rast “Vjedhje”, 1 rast “Vjedhje në tentativë” 1 rast “Sulm”. Kjo ishte në pikat e shkurta, jam i hapur që të ju përgjigjem pyetjeve tuaja.

Shahip Shala – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të denoncoj ose të ju informoj për një keqpërdorim i detyrës zyrtare që është duke u bërë, fjalën e kam për KF – Rahovecin. Ky klube nga subvencionet e komunës vitin e kaluar ka përfituar 25,000.00 €, por nga ana tjetër të gjitha transaksionet financiare që i ka bërë ky klub si pagat e futbollistëve, të anëtarëve të kryesisë i kanë kryer me para në dorë e o përmes bankës, kjo sipas meje është vepër penale sepse është bërë abuzim me paranë publike ku ka edhe korrupsion. Arsyeja pse e them këtë është sepse nga 1,500.00 € derivate që kanë shpenzuar sipas tyre, vetëm 900.00 € janë të arsyetuara. Kërkoj që klubin e futbollit KF – Rahovecit të i bëhet auditim sepse këto para nuk janë as të kryetarit dhe as të Shahip Shalës por janë parat e të gjithë taksapaguesve, prandaj duhet që të jepet llogaridhënie për shpenzimet e tyre, e jo të bëhet arsyetimi që lojtarët nuk kanë pranuar që pagesa të ju bëhet përmes bankës. I nderuari kryetar kjo praktik ka qenë edhe në vitet e kaluara por nuk e di se sa jeni ju në dijeni, por besoj se kjo veprimtari është fshehur nga ju, por kush e ka fshehur këtë nga ju unë nuk e di. Ky klub ka marrë rreth 15,000.00 € mjete financiare edhe nga federata e futbollit dhe donatorët, por ajo që mua më intereson është shpenzimet e parës së komunës, por duke ju njohur juve nga afër kryetar, nuk e besoj që do të lejoni që këto gjëra të ndodhin në klubin e KF- Rahovecit. Nëse i krahasojmë klubet e tjera dhe KF- Rahovecin që e ka dërguar një raport që besoj edhe nxënësi i klasës së 7 kishte me bë më mirë, ndërsa sipas DKRS-së raportet financiare janë duke u bërë në mënyrë profesionale nga ana e KB – Rahovecit, KH- Rahoveci dhe të klubeve të futsallit, sepse ata të gjitha transaksionet janë duke i bërë përmes bankës dhe kjo është për çdo lavdat. KH – Rahoveci vitin e kaluar ka marrë 5 herë më pak mjete se sa KF- Rahoveci dhe ky klub i hendbollit këtë vite do na përfaqësoj në garat ndërkombëtare sepse janë bindshëm në tabelë, ky klub është i organizuar shumë mirë. Kur kemi të bëjmë me subvencionime të klubit, të ju them të drejtën duhet të ketë edhe kritere dhe jo subjektivizëm, kriteri është rangi i garave dhe suksesi i treguar, kaq e kisha ju faleminderit.

Kryetari – Falënderoj komandantin e stacionit të policisë kapitenin Fazli Morina për këto informacionet e rëndësishme që na i dha. Sa i përket shqetësimit që e shprehu i nderuari z. Shahip Shala, e kuptoj të nderuarin, por ndoshta kishte me qenë më mirë nëse do të ishte drejtuar tek zyra e kryetarit ose tek DKRS-ja. I nderuar ne do të shikojmë me vëmendje këtë shqetësimi tuaj, unë e di se ju i nderuar jeni gëzuar shumë më shumë se ne të gjithë kur KF- Rahoveci ka hyrë në ligën e parë, poashtu edhe ne edhe ti jemi gëzuar edhe për KH- Rahoveci që ka ecur përpara si klub, poashtu jam i pajtimt që KH- Rahoveci duhet të i ndihmohet më shumë. Ne si komunë jemi të interesuar që të i kemi raporte sa më profesionale dhe të bazuar në ligje, nëse nuk do të jetë kështu do të ketë masa ndëshkimore, ne si komunë e kemi përkrahur edhe sportin edhe rininë, do të vazhdojmë që ti përkrahim por jo më pa i deklaruar se ku kanë shkuar cent për cent shpenzimet e bëra. Drejtoret e shkollave së bashku me këshillin e prindërve e kanë për obligim që të raportojnë në institucione të sigurisë për veprimet e paligjshme që ndodhin brenda dhe përreth mjediseve shkollore, do i dërgojë një qarkore drejtoreve të shkollës dhe nëse ata nuk i përgjigjen atëherë do të ketë ndëshkime për secilin i cili tenton që të fsheh veprime ose ndodhi të cilat janë të pa tolerueshme dhe të paligjshme. Prandaj apeloj organet e drejtësisë dhe të sigurisë që të vazhdojnë ti kryejnë detyrat e tyre të cilat ju takojnë, meqenëse ne tani i kemi kamerat më funksionale e lusë policinë që të patrollojnë më shumë që tek rruga Hamoc – Fortesë, Xërxë – Sopni – Ratkoc, rruga për Therandë, tek Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbi Rahovec, Maja e Shkodranit, patrullime në afërsi të 4 shkollave të mesme, rruga për në Hoçë të Madhe, rruga që e lidhë Rahovecin me Prizren ka Zoqishti – Retija – retija e Ulët, e di që këto janë sfida por janë edhe qëllime tona të mëdha që kemi sa ma shumë veprime parandaluese ndaj dukurive negative. Jam dakord me atë që e tha komandanti sa i përket shenjëzimit të rrugëve rajonale dhe magjistrale, ka vite që rruga Rahovec – Xërxë nuk është sinjalizuar, pastaj rruga Rahovec - Malishevë dhe shumë e shumë rrugë tjera.

Konkluzë – Do të vazhdojmë me zgjerimin e projektit të kamerave të sigurisë, jemi të interesuar që këto kamera të instalohen në çdo fshat të komunës së Rahovecit.

Me instalimin e kamareve rastet janë duke u zbuluar, harroi të cekë komandanti se rreth 30 raste janë zbuluar kjo falë edhe ndihmës të kamerave, inkurajoj policin dhe organet komunale, poashtu edhe anëtarët e KKSB-së që ta risim angazhimin tonë në mënyrë që siguria e përgjithshme e jetës, pronës publike dhe private të jetë në nivelin e duhur.

Konkluzë – Organet tona të mos bëjnë kompromise, por të zbatojnë rendin dhe ligjin në mënyrë që të kemi më shumë siguri për qytetarët tanë. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Të ndryshme.

Kryetari – Të nderuar në këtë mandat besoj se takimet e KKSB-së do të jenë më të shpeshta, ne edhe ashtu për çdo vite kemi mbajtur 6-7 takime, por besoj se tani do të kemi më shumë se kaq.

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 16.45


Procesmbajtësi
Agim Hoti


Kryetari i Komunës
Sinan Latifi